

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7117
E mërkurë, 14 shkurt 2024
Çmimi 0.50 €

BE-ja: Projektligji për KPM-në të mos ndikojë negativisht në lirinë e medieve | **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AVOKATI I SHALËS, I BAHTJARIT DHE I JANUZIT ANKOHEN SE MINISTRIA E DREJTËSISË NUK PO I KOMPENSON, KËRKOJNË PEZULLIMIN E PROCESIT

FAQE 5



Mbrojtja e Haxhi Shalës, e Ismet Bahtjarit dhe e Sabit Januzit është ankuar se nuk është duke u financuar nga Ministria e

Drejtësisë (MD) për t'i përfaqësuar juridikisht të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK)

në Hagë. Për këtë arsye avokatët kanë kërkuar pezullimin e këtij procesi derisa të zgjidhet kjo çështje

KURTI: LIBERALIZIMI I VIZAVE KA RRIUR INTERESIMIN E SERBËVE PËR T'U PAJISUR ME PASAPORTA TË KOSOVËS

F. 3



PE-ja KËRKON QË KOSOVA DHË SERBIA TË ANGAZHohen PËR NORMALIZIMIN E MARRËDHËNIEVE

F. 5



NDALËSA E IMPORTEVE NGA SERBIA RRIUR ÇMIMET NË KOSOVË

F. 8

SPORT



MBAHET TRYEZA E PESTË PËR SPORTIN

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Senati amerikan miraton paketën e ndihmës për Ukrainën

UASHINGTON, 13 SHKURT - Senati amerikan ka miratuar paketën e ndihmës në vlerë prej 95.34 miliardë dollarësh, ku përfshihet edhe ndihma ushtarake dhe ekonomike për Ukrainën në vlerë prej 61 miliardë dollarësh. Megjithatë, fati i këtij legjislacioni mbetet i paqartë, pasi republikanët që kontrollojnë Dhomën e Përfaqësuesve kanë sinjalizuar se nuk do t'i mbështesin këto masa.

Senatorët amerikanë votuan me 70 vota për dhe 29 ishin kundër këtij projektligji, duke tejkaluar 60 votat e nevojshme për miratim. Kjo u arrit pasi 22 senatorë republikanë iu bashkuan atyre demokratë për të mbështetur këtë paketë të ndihmës. Në paketën e miratuar përfshihen edhe 14 miliardë dollarë ndihmë për Izraelin dhe ndihmë për shtetet e tjera. Presidenti ukrainas

Volodymyr Zelensky falënderoi Senatin amerikan për miratimin e këtij legjislacioni. "Për ne në Ukrainë vazhdimi i ndihmës së ShBA-së na ndihmon të shpëtojmë jetë nga terrori rus. Kjo nënkupton se jeta do të vazhdojë në qytetet tona dhe do të triumfojë ndaj luftës. Ndihma amerikane sjell më afër paqen në Ukrainë dhe rivendos stabilitetin botëror, duke rezultuar në rritje të sigurisë dhe prosperitetit për



të gjithë", ka shkruar ai në "X", që më herët njihej si "Twitter". Ndihma financiare dhe ushtarake amerikane ka qenë

thelbësore për Ukrainën, shtet që po lufton kundër pushtimit që Rusia nisi pothuajse dy vjet më parë.

Trumpi i kërkon Gjykatës Supreme të ndërhyjë në çështjen e imunitetit



UASHINGTON, 13 SHKURT - Donald Trump i ka kërkuar Gjykatës Supreme amerikane më 12 shkurt që të pezullojë një vendim gjyqësor që hodhi poshtë pretendimin e tij se ka imunitet nga ndjekja penale për rastin gjyqësor, ku ai po akuzohet se tentoi ta përmbyste humbjen në zgjedhjet e vitit 2020. Ai ka argumentuar se pa një mburojë të tillë, "presidenca, siç ne e njohim, nuk do të ekzistojë më". Trumpi, që po synon t'i fitojë zgjedhjet presidenciale amerikane të nëntorit, u ka kërkuar gjykatësve të pushojnë vendimin e 6 shkurtit, që u mor nga një panel gjyqarësh të Gjykatës Supreme të Qarkut

Kolumbia. Paneli prej tre gjyqtarësh hodhi poshtë pretendimin e Trumpit se ai ka imunitet nga përndjekja ligjore. Avokatët e Trumpit, në kërkesën dorëzuar në Gjykatën Supreme, thanë se "mbajtja e gjyqit penal për muaj të tërë ndaj presidentit Trump në mes të një sezoni zgjedhore do ta dëmtojë në mënyrë drastike aftësinë e Trumpit për të bërë fushatë" kundër presidentit Joe Biden për zgjedhjet e nëntorit.

Avokatët kërkuar që gjykatësit t'i pezullojnë procedurat gjyqësore, pasi po kërkojnë që kjo çështje të rishqyrtohet nga një gjykatë në

qarkun e Uashingtonit dhe nëse është e nevojshme, më pas të apelohej në Gjykatën Supreme. Në një gjykatë federale në Uashington ishte paraparë që të niste gjyqi ndaj Trumpit më 4 mars, nën akuzat për përmbysje të rezulttit. Data e nisjes së gjyqit është shtyrë dhe nuk është vendosur një datë e re.

Trumpi, që përballet me katër akuzat penale, është ish-presidenti i parë amerikan që ndiqet penalisht. Ai konsiderohet kandidati kryesor për ta fituar nominimin e republikanëve për ta sfiduar demokratën Biden në zgjedhjet e nëntorit.

Huthët sulmojnë një anije që ishte nisur drejt Iranit

TEHRAN, 13 SHKURT - Ushtria amerikane tha se lëvizja rebele jemenase Huthi ka lëshuar raketa drejt një anijeje tregtare në jug të brigjeve të Jemenit, që ishte nisur drejt Iranit. Anija raportohet se ka pësuar dëme të vogla nga sulmi dhe ka vazhduar lundrimin e saj drejt Iranit.

"Më 12 shkurt, nga ora 03:30 deri në 03:35 [sipas kohës lokale në Sana], militantët e Huthit, të mbështetur nga Irani, gjuajtën dy raketa nga zonat që i kontrollojnë në Jemen drejt Baba al-Mandeb", tha Komanda Qendrore amerikane në "X". Firma e sigurimit, "Ambrey", tha se

anija ishte e regjistruar në ishujt Marshall dhe ishte në pronësi të Greqisë. Ajo u "sulmua nga raketat në dy incidente të ndara" që ndodhën brenda 20 minutash. "Raportohet se u godit dhe pësoi dëme", tha Ambrey, duke shtuar se një ekip i armatosur i sigurisë private ishte në bordin e anijes. "Grupi i pronarëve ishte i listuar në indeksin amerikan të bursave, NASDAQ, që dyshohet të jetë arsyeja e sulmit", tha kjo kompani. Komanda Qendrore amerikane tha se anija MV Star Iris "po kalonte në Detin e Kuq dhe ishte duke transportuar misër nga Brazili".

Destinacioni i anijes ishte një port në Iran, tha ushtria amerikane. Huthët, që janë pjesë e "boshtit të rezistencës"- një aleancë kundër Perëndimit dhe kundër Izraelit që përbëhet nga grupet e mbështetura nga Irani - kanë sulmuar anijet tregtare në Detin e Kuq, që nga nëntori, në mbështetje të palestinezëve në Rripin e Gazës ku Izraeli dhe Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - po luftojnë. Sulmeve të Huthëve u janë kundërpërgjigjur me sulme ShBA-ja dhe Britania e Madhe.



Mbreti Charles kthehet sërish në Londër pas trajtimit të kancerit



LONDËR, 13 SHKURT - Mbreti Charles u kthye të martën në Londër pasi iu nënshtrua trajtimit të kancerit në Sandringham. Monarku 75-vjeçar zbarkoi në Clarendon House me helikopter mbretëror, pasi kaloi një

javë në Norfolk. Mbreti u fotografua me gruan e tij Camilla teksa po shkonin drejt Clarence House. Të dielën Charles u pa në daljen e tij të parë publike që nga fillimi i trajtimeve të

rregullta duke ecur në kishë në Sandringham me Camilla. Të shtunën ai foli për herë të parë duke shprehur falënderimet e tij të ngrohta për mbështetësit që i urojnë shërim të shpejtë.

Kurti: Liberalizimi i vizave ka rritur interesimin e serbëve për t'u pajisur me pasaporta të Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

LONDËR, 13 SHKURT - Në Londër të Mbretërisë së Bashkuar, kryeministri Albin Kurti mori pjesë në panelin e diskutimit të organizuar nga instituti "Chatham House", në të cilin ishte një nga folësit kyçë. Temë e diskutimit ishin sfidat e sigurisë me të cilat ballafaqohet rajoni, përkatësisht Ballkani Perëndimor. Në fjalën e tij hyrëse, ai fillimisht foli për progresin, arritjet dhe politikat e qeverisjes së deritanishme dhe rezultatit e tyre në rritjen e mirëqenies të qytetarëve dhe lehtësimin e integritetit të komunitetit serb në Kosovë. Kurti veçoi faktin që liberalizimi i vizave që hyri në fuqi më 1 janar të këtij viti ka rritur interesimin e serbëve të Kosovës për t'u pajisur me pasaporta të Kosovës, si dhe konvertimin e suksesshëm në targa të Kosovës për vetura nga ato ilegale të Serbisë në mesin e pronarëve nga radhët e komunitetit serb në Kosovë. Sa iu përket rreziqeve dhe sfidave

të sigurisë, kryeministri Kurti ka theksuar se aleanca e fortë e Serbisë me Rusinë nuk është vetëm rrezik teorik për Evropën dhe Ballkanin Perëndimor, por është rrezik real, me të cilin Kosova, por jo vetëm, përballet rregullisht. Ai shtoi se prania e Rusisë në Ballkan po rritet nëpërmjet Serbisë dhe se në këtë kontekst një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është më urgjente se kurrë. Mosnënshkrimin e deritanishëm të marrëveshjes, kryeministri e cilësoi si shenjë të qartë të mungesës së mirëbesimit, i cili është i nevojshëm për të pasur siguri ligjore dhe zbatim të asaj për çka palët janë pajtuar. Për më tepër, kryeministri theksoi se refuzimi për ta nënshkruar marrëveshjen nënkupton se Serbia dëshiron ta lë të hapur opsionin e invazionit në Kosovë. "Siguria e Kosovës dhe mbështetja për të është baza mbi të cilën vendi ynë mund të vazhdojë të rritet", nënvizoi kryeministri Kurti, teksa tha se Serbia, apo cilido aleat potencial i



Rusisë, nuk mund ta mbajë rajonin larg BE-së sepse kjo do t'i shërbente vetëm Rusisë dhe përpjekjeve të saj për ta ndarë përsëri kontinentin. Andaj ai tha se nga BE-ja duhet një qasje e cila nxit përaftrimin e vendeve të rajonit në Bashkimin Evropian

mbi baza meritore, në vend se i gjithë rajoni të mbetet peng i një vendi të vetëm. Serbia me regjimin e saj autoritar po e mban të gjithë rajonin prapa", tha ai. Diskutimi i cili zgjati rreth një orë u moderua nga redaktorja e gazetës "The Telegraph", Danielle

Sheridan. Panelistë të tjerë përkrah kryeministrit ishin Andin Hoxhaj, ligjërues në Kolegjin Universitar të Londrës (University College of London) dhe Armida van Rij, hulumtuese e lartë në Institutin "Chatham House".

Rama në Dubai: Dolëm nga një terr shumë i gjatë, ishim Koreja e Veriut të Evropës



PRISHTINË, 13 SHKURT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ish-kryeministri anglez, Tony Blair, ishin pjesë e panelit të Samitit Botëror të Qeverisjes në Dubai. Rama gjatë diskutimit ka thënë se Shqipëria doli nga një terr shumë i gjatë, duke theksuar se ishin Koreja e Veriut të Evropës. Ai ka theksuar se Tony Blair ishte modeli i tij prej politikani. "Doja që kjo të ishte e qartë, sepse kështu të gjithë do të kuptoni që nuk do të isha më i privilegjuar se kaq sesa të kem dikë, do t'i them që unë nuk do të jem as kryeministër as do të isha asnjë njeri i angazhuar në politikë përpara tij, nëse s'do të ishte për të, ishte modeli im për të hyrë në politikë dhe për PS-në, mund të jetë një rrugë e tretë për të majtën. Dolëm nga një terr shumë i gjatë. Ishim Koreja e Veriut të Evropës, të izoluar, ishim të vetmuar në një varfëri që sot më duket e pamundur nga një izolim i jashtëzakonshëm. Ajo çfarë mësuam me mundim është që

sistemin mund ta ndryshosh brenda ditëve, por institucionet nuk i ndërton dot as për vite të tëra", ka thënë Rama. Kryeministri shqiptar ka thënë se në skenarin ideal për pesë vjet do të dëshironte që Shqipëria të ishte një vend që sillet dhe punon si vend anëtar i BE-së. "Pastaj nëse do të jetë zyrtarisht pjesë e BE-së nuk është vendimi ynë. Dua të them që ka të bëjë me teknologjinë, por edhe jo me të. Po flisnim edhe përpara rreth faktit ku do të shkojë kjo teknologji e çfarë do të ndodhë, por për një gjë që nuk e di nëse jam i sigurt që teknologjia nuk do ta bëjë dot kurrë, janë dielli, lumenjtë, luginat, plazhet e mrekullueshme, malet, liqenet fantastike dhe qytetarët mjaft mikpritës të Shqipërisë. Dua t'u them të gjithëve që e jani në Shqipëri dhe në atë mjedis do të keni mendime më të mira se si teknologjia mund ta përplotësojë bekimin nga Zoti të një vendi që është mallkuar shumë nga historia", ka thënë Rama.

Pas Preshevës, kryebashkiaku Erion Veliaj shpallet "Qytetar Nderi" nga komuna e Bujanocit

TIRANË, 13 SHKURT - Pas Preshevës, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, është shpallur "Qytetar Nderi" edhe nga komuna e Bujanocit. Ishte kryetari i Kuvendit të Komunës së Bujanocit, Enver Ramadani, ai që propozoi nderimin e kryebashkiakut Veliaj në shenjë falënderimi

për financimin e përmirësimit të kushteve infrastrukturore në Shkollën Filllore "Naim Frashëri". "Kuvendi Komunal i Bujanocit në seancën solemne ka votuar për ndarjen e titullit 'Qytetar Nderi' i Komunës së Bujanocit kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj.

Në seancë morën pjesë 23 këshilltarë, dhe të gjithë votuan për, pa asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Tani mbetet që Ministria e Administratës Shtetërore dhe Pushtetit Lokal ta japë pëlqimin për zyrtarizimin e titullit 'Qytetar Nderi', ka njoftuar komuna e Bujanocit.





Avokati i Shalës, i Bahtjarit dhe i Januzit ankohen se Ministria e Drejtësisë nuk po i kompenson, kërkojnë pezullimin e procesit

HAGË, 13 SHKURT - Mbrojtja e Haxhi Shalës, Ismet Bahtjarit dhe Sabit Januzit janë ankuar se nuk janë duke u financuar nga Ministria e Drejtësisë (MD) për t'i përfaqësuar juridikisht të akuzuarit gjatë procesit gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë. Për këtë arsye, ata kërkojnë pezullimin e këtij procesi derisa të zgjidhet kjo çështje.

Në parashtrimet e tij, avokati i Januzit, Jonathan Elystan Reese, tha se një kërkesë për financim e kishte bërë më 4 dhjetor 2023, por që deri tani nuk ka ndonjë rezultat, raporton "Betimi për Drejtësi". "Mbrojtja e Januzit ka bërë kërkesë në përputhje me kriteret e saj më 4 dhjetor 2023. Sipas kriterëve, Ministria e Drejtësisë duhet të krijojë një komision për t'i dhënë përgjigje kësaj kërkesë brenda 10 ditësh. Ne i kemi kërkuar vazhdimisht MD-së që të trajtojë këtë kërkesë brenda dhjetë ditësh të parashikuara dhe më pas këtë e kemi bërë përmes një korrespondencë inter-partes ku MD-ja kërkonte që ta shtyjme këtë çështje, ndërkohë që do të

zgjidhnin çështjen e mungesës së numrit të duhur të personave që do të merrnin pjesë në komision", tha Reese.

Ai tha se Ministria e Drejtësisë u ka dhënë disa data se kur do të mbahej takimi i këtij Komisioni, e që kjo ka zgjatur që nga dhjetori deri në javën e kaluar. "Ne na i kanë dhënë disa data kur do të takohej ky Komision dhe herë pas here në çdo rast na kanë thënë që do të vonohen më tutje për të vazhduar gjatë gjithë dhjetorit, janari dhe shkurtit dhe deri në javën e shkuar. Ne jemi përpjekur që të vazhdojmë bashkëpunimin tonë dhe iu kemi besuar kur na kanë thënë se do të zgjidhej kjo çështje, por në fakt kjo është kosto për ne, është dështim për ne pasi edhe sot që ndodhemi këtu, nuk është na është komunikuar ndonjë vendim i ndonjë takimi... Është shtyrë vazhdimisht. Unë nuk jam në gjendje që të tregoj ndonjë afat. Unë po them se na kanë thënë që do të mbahet një takim i ri gjatë kësaj jave se a do të mbahet a jo, nuk e di", tha ai. Mbrojtja e Januzit kërkonte që t'i

vendoset një afat urgjent Ministrisë së Drejtësisë për këtë çështje dhe në rast që nuk bëhet, atëherë çështja të dërgohet në Kushtetuese. "Nëse ju do të bëni këtë gjë dhe do t'i vendosni Ministrisë së Drejtësisë një afat urgjent dhe në qoftë se nuk zbatohet ky afat, mua më duket se rezultati do të ishte që këtë çështje ta dërgojmë në Dhomën Kushtetuese. Edhe në këtë rast do t'i kërkonim trupit gjyqësor që kjo çështje të zgjidhet sa më shpejtë të jetë e mundur duke iu referuar apo duke çuar çështjen në Dhomën Kushtetuese nga vetë trupi gjyqësor me qëllim që ato të mund ta ndjekin çështjen e moszbatimit të angazhimit që ka MD-ja sipas ligjit", tha Reese. Avokatja e Ismet Bahtjarit, Felicity Gerry KC, tha se e mbështet parashtrimin e mbrojtjes së Januzit. "Dua ta mbështes parashtrimin e z. Reese dhe të bëj të njëjtën kërkesë në emër të z. Bahtjarit. Ne jemi në të njëjtën gjendje. Kemi bërë një numër kërkesash pranë Ministrisë së Drejtësisë për t'i dhënë përgjigje kërkesës

sonë për financim dhe kur u bë e qartë që ky takim i Komisionit nuk do të mbahej gjatë javës së shkuar, unë e njoftova vetë zyrën administrative se kishte një problem. Të njëjtën gjë bëra edhe me ZPS-në", tha Gerry.

Ajo potencoi se nuk ka marrë asnjë e-mail që nuk do të miratohet fondet, por që është informuar se duhet të formohet një komision.

Avokatja Gerry tha se është duke kërkuar edhe një kontroll mjekësor për të mbrojturin e saj për të parë nëse ai është në gjendje të ndjekë këtë proces gjyqësor në DhSK, kurse shtoi se këtë seancë është duke e ndjekur përmes video-lidhjes për shkak të mungesës së financimit.

Mbrojtja e Bahtjarit kërkonte që të pezullohet kjo konferencë me qëllim që Ministria e Drejtësisë të përgjigjet në bazë të kërkesave që ia kanë bërë. "Kërkoj nga ju që ta pezulloni këtë konferencë të sotme me qëllim që Ministria e Drejtësisë të përgjigjet në bazë të kërkesës që kemi bërë, kërkesës që ka bërë z. Reese dhe ne të vijmë

këtu nesër dhe të kemi përditësimin e duhur. Ndërkohë mund të them që nuk është e drejtë, ne kemi nevojë për ndihmën e trupit gjyqësor që të respektohen të drejtat e z. Bahtjarit për një gjykim të drejtë", tha Gerry KC.

Ndërsa avokati i Haxhi Shalës, Toby Cadman, tha se nuk do t'i përsërisë gjërat që kanë thënë dy parafolësit e tij lidhur me komunikime. Cadman potencoi se kjo çështja e financimit nuk do të ndikojë në përfaqësimin juridik të Haxhi Shalës. "Edhe ne jemi të prekur në të njëjtën mënyrë. Ajo që mund të them është se unë i kam premtuar z. Shalës se pavarësisht financimit, ne do të vazhdojmë ta përfaqësojmë atë. Sigurisht, që kemi nevojë për një vendim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë. Ne e kemi diskutuar me z. Shalës çështjen e sigurimit të fondeve përmes DhSK-së në qoftë se Ministria nuk jep përgjigjen e duhur. Por, z. Shalës është i paraburgosur për një periudhë prej dy muajsh dhe nuk duam që të ketë vonesa me tej të kësaj çështje. Sa i përket hetimeve

PE-ja kërkon që Kosova dhe Serbia të angazhohen për normalizimin e marrëdhënieve

Parlamenti Evropian (PE) ka nisur të martën procedurën e miratimit të propozimit të Komisionit Evropian (KE) për planin e rritjes dhe reformave për Ballkanin Perëndimor, i cili ofron një shumë të përgjithshme prej 6 miliardë eurosh ndihmë shtesë financiare. Në kuadër të propozimit të rregullores për themelimin e planit për reforma dhe rritje ekonomike në Ballkanin Perëndimor, u është bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të angazhohen për normalizimin e marrëdhënieve të të gjitha marrëveshjeve nga e kaluara në dialog

STRASBURG, 13 SHKURT - Parlamenti Evropian (PE) e ka nisur të martën procedurën e miratimit të propozimit të Komisionit Evropian (KE) për planin e rritjes dhe reformave për Ballkanin Perëndimor, i cili ofron një shumë të përgjithshme prej 6 miliardë eurosh ndihmë shtesë financiare. Për t'u zyrtarizuar ky plan është i domosdoshëm pajtimi ndërinstitucional në Bashkim Evropian (BE), që kërkon edhe miratimin nga Parlamenti Evropian. Parlamenti është nën presion për ta aprovuar sa më shpejt këtë vendim për shkak se në prill do ta mbajë seancën e fundit plenare me këtë përbërje para

zgjedhjeve të reja të PE-së në gershor. Të martën u paraqit edhe propozim-rezoluta legislative për rregulloren për themelimin e planit për reforma dhe rritje ekonomike. Për këtë u diskutua të njëjtën ditë gjatë një takimi të përbashkët të komisioneve të PE-së për Politikë të Jashtme dhe për Buxhet. Parlamenti Evropian, krahas kushtëzimeve që i ka propozuar më herët edhe Komisioni, ka kërkuar edhe masa shtesë me të cilat do të kushtëzohej përdorimi i mjeteve financiare nga ky plan, në mënyrë që të sigurohet më mirë mbrojtja e interesave të Bashkimit

Evropian. Ndër kushtet kryesore për përdorimin e këtyre mjeteve janë sundimi i ligjit, respektimi i të drejtave të njeriut dhe respektimi i vlerave themelore e demokratike. Parlamenti Evropian ka kërkuar që, mes të tjerash, përdorimi i mjeteve të kushtëzohet edhe me mbështetjen e qëndrimeve të BE-së në politikën e jashtme dhe të sigurisë, përfshirë edhe sanksionet ndaj Rusisë. "Një parakusht tjetër do të jetë përshtatja me politikën e përbashkët të jashtme dhe sigurisë të Unionit, përfshirë miratimin e masave kufizuese ndaj Rusisë, sikur edhe me kërkesat e BE-së për viza për vendet e treta", thuhet në amendamentin që ka propozuar Parlamenti Evropian si kusht shtesë për përdorimin e këtyre mjeteve. Ky propozim-ndryshim mund të ketë efekt kryesisht në rastin e Serbisë, pasi ajo është vendi i vetëm i rajonit të Ballkanit Perëndimor i cili nuk i ka mbështetur sanksionet e BE-së ndaj Rusisë. Por, për t'u përfshirë kjo në kushtëzime duhet të pranohet edhe nga Këshilli i BE-së, ku vendosin vendet anëtare të bllokut.

Kosovës dhe Serbisë do t'u kërkohej specifikisht të angazhohen në mënyrë konstruktive për normalizimin e marrëdhënieve. "Parakusht do të jetë që Serbia dhe Kosova të angazhohen në mënyrë konstruktive për normalizimin e marrëdhënieve mes tyre me qëllim të zbatimit të plotë të obligimeve përkatëse që dalin nga Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit dhe Aneksit për zbatimin, si dhe të gjitha marrëveshjeve nga e kaluara në dialog dhe të angazhohen në negociatën për marrëveshjen gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve", thuhet në propozimin e rregullores. Parlamenti Evropian ka propozuar që këtu të shtohet edhe një sqarim që kërkohej "rezultat i qartë, i matshëm dhe rezultate konkrete". Sipas këtij plani, rajoni i Ballkanit Perëndimor ka në dispozicion 6 miliardë euro shtesë për rritje ekonomike dhe reforma të BE-së. Këto mjete do të kenë një kushtëzim të shtuar dhe do të përdoren vetëm nëse respektohen ato. Nga kjo shumë, 2 miliardë do të

jenë në formën e granteve pa kthim për përfituesit, ndërsa 4 miliardë do të jenë kredi të favorshme për të cilat do të garantonte BE-ja. Sipas propozimit të Komisionit Evropian, gjysma e mjeteve nga plani për rritje në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të shkojnë në kuadër të kornizës për investime, sepse mjetet ekzistuese që janë në dispozicion nuk konsiderohen të mjaftueshme për të tërhequr investime të duhura. Pjesa tjetër do të shkojë direkt në buxhetin e vendeve për të financuar disa nga reformat e nevojshme. Komisioni Evropian beson se ky plan do ta ndryshojë shumë Ballkanin dhe do të jetë gjenerator për rritje të konsiderueshme ekonomike dhe me këtë do ta ndihmojë edhe progresin e këtyre vendeve drejt integritimit në BE. Parlamenti Evropian kërkon që të bëhet e qartë se instrumentet e para anëtarësimit (IPA) të mbeten mjetet kryesore për t'i ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor dhe së mjetet nga plani për reforma dhe rritje ekonomike të jenë vetëm shtesë e jo zëvendësim i këtyre instrumenteve. /REL/



afatgjate që do t'i bëjë, pala mbrojtëse sigurisht që do të preket nga kjo çështje e financimit", tha Cadman. Ai tha se ia ka bërë të qartë Shalës se kjo çështje e financimit nuk do ta prekë faktin se do ta përfaqësojnë në këtë proces, pasi kanë detyrime të cilat do t'i përmbushin. Ndërsa prokurorja Jasmine Shahabbudin nga ZPS kundërshtoi kërkesat për pezullim të procedurës. "ZPS-ja

kundërshton çdo kërkesë për të pezulluar apo vonuar procedurën bazuar në këtë problem të financimit që u shtjellua sot në hollësi. Mendoj që pika kryesore këtu është që DhSK-ja ka një kornizë funksionale gjithëpërfshirëse për të trajtuar çështjet e përfaqësimit dhe financimit", tha Shahabbudin. Kurse Gerry KC kërkoi sërish që ky proces të pezullohej për një afat prej një muaji.

Ndërsa ZPS-ja tha se ka mekanizma pranë DhSK-së që e trajtojnë financimin e mbrojtjes së të akuzuarve. Në rast se Ministria e Drejtësisë nuk do të paguajë për mbrojtjen e të akuzuarve, gjyqtari i procedurës paraprake, Nicholas Guillou, tha se është sistemi i ndihmës financiare pranë DhSK-së dhe se ata do të paguheshin ose nga ky sistem ose nga vetë të akuzuarit. "Dua ta bëj të qartë që nuk do ta bëj që

kjo çështje të ngelet peng i gatishmërisë së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për t'i financuar ekipet e mbrojtjes dhe do të marrë urgjentisht vendimin lidhur me çështjen nëse Ministria do t'i paguajë apo jo ekipet e mbrojtjes. Në qoftë se MD-ja merr vendim negativ apo nuk e merr vendimin në ditët në vazhdim, ne kemi një kuadër ligjor. Ne kemi sistemin e ndihmës financiare ligjore e cila

aktivizohet në momentin që të akuzuarit nuk janë në gjendje të paguajnë për ekipet e tyre të mbrojtjes. Në qoftë se Ministria e Drejtësisë nuk dëshiron të kontribuojë për pagesat për mbrojtjen e të akuzuarve pranë DhSK-së, mbrojtësit do të paguheshin ose nga të akuzuarit ose përmes sistemit të ndihmës ligjore", tha Guillou. Ai shtoi se është e rëndësishme që MD-ja të dalë me një vendim.

Totaj vëzhgon punimet që po zhvillohen në ndërtimin e QKMF-së së re në Prizren

PRIZREN, 13 SHKURT - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me zyrtarë të ekzekutivit, kanë vëzhguar nga afër punimet që po

zhvillohen në ndërtimin e QKMF-së së re, në ambientet e ish-kampit të KFOR-it (Innovation and Training Park - ITP) në Prizren.

Totaj ka theksuar se ky objekt, me rreth 1 500 metra katrorë, është një projekt modern si në aspektin infrastrukturor, po ashtu edhe në atë të ofrimit të

shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Prizrenit si dhe do të ofrojë hapësirë të mjaftueshme parkimi për pacientët.



Përkujtohet dëshmori Avni Hajredini në 24-vjetorin e rënies

MITROVICË, 13 SHKURT - Me rastin e 24-vjetorit të rënies së dëshmorit Avni Hajredini, i cili sakrifikoji jetën në mbrojtje të Mitrovicës, përfaqësues komunal, drejtues të shoqatave të dala nga lufta si dhe familjarë, kanë vendosur buqeta me lule te pllaka përkujtimore në vendin e rënies, në 'Lagjen e Boshnjakëve' në veri të qytetit dhe te varrezat e dëshmorëve në Shipol.

Gjatë këtyre homazheve është vlerësuar lart kontributi i dëshmorit Avni Hajredini, për çështjen kombëtare dhe për

çlirimin e vendit e të Mitrovicës, duke thënë se angazhimi i tij për të mirën e kombit e sidomos për të mirën e Mitrovicës na bënë të ndihemi krenarë.

Dëshmori Hajredini ishte vrarë më 13 shkurt të vitit 2000 në "Lagjen e Boshnjakëve", në veri të qytetit të Mitrovicës, në momentin kur po kalonte nëpër lumin për të dalë në veri në mbrojtje të shqiptarëve që ishin sulmuar barbarisht nga bandat kriminale serbe duke ushtruar terror të vërtetë mbi ta dhe po ndiqeshin nga shtëpitë e tyre.



Drenasi nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për trajtimin human të qenve endacakë

DRENAS, 13 SHKURT - Komuna e Drenasit ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për trajtimin human të qenve endacakë për këtë vit në bashkëpunim me Fondacionin Stray Coco. Ky është një projekt i rëndësishëm për ta siguruar trajtimin e duhur për qentë. "Trajtimi do të bëhet nëpërmjet stafit profesional të Veterinarisë 'CityPet - Hospital', me synimin e qartë për ta përmirësuar mirëqenien e qenve endacakë në territorin tonë. Qëllimi ynë është të bëhet trajtimi i qenve endacakë, duke parandaluar rreziqet për shëndetin dhe jetën e qytetarëve. Përveç kësaj, synojmë edhe ta parandalojmë përhapjen e sëmundjeve infektive si zoonozave dhe tërbimit, përmes vaksinimit dhe ekinokozes me tableta, sterilizimit dhe dehelmatizimit", ka njoftuar komuna e Drenasit.

Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë ka kërkuar nga qytetarët tanë që të bashkëpunojnë me ambulanten e veterinerëve dhe

autoritetet lokale në këtë projekt të rëndësishëm. "Me përkrahjen dhe angazhimin tuaj do të mund të sigurojmë trajtim sa më human për qentë tanë endacakë dhe t'i mbikëqyrim qentë shtëpiakë

për t'i parandaluar rreziqet që po paraqiten për qytetarët. Faleminderit për përkrahjen dhe bashkëpunimin tuaj në këtë projekt të rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve tanë!", ka njoftuar komuna e Drenasit.



Mjekët ia shpëtojnë jetën njëvjeçarit, kishte gëlltitur një pjesë të lodrës

PRISHTINË, 13 SHKURT - Përdorimi i lodrave plastike nga fëmijët, në disa raste mund të shndërrohet në rrezik dhe jetë kërcënues. Një rast i tillë i rrezikimit të jetës te një fëmijë i moshës njëvjeçar është paraqitur në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës, ku fëmija gjatë lojës me një lodër kishte aspiruar një pjesë të lodrës dhe kishte vështirësi të madhe në frymëmarrje. Fëmija i moshës njëvjeçare menjëherë nga Klinika Emergjente është transferuar në Klinikën e Otorinolaringologjisë për shkak të aspirimit të trupit të huaj (lodër plastike e rrumbullakët), gjë që e bën shumë të vështirë heqjen e trupit të huaj.

Në këto kushte fëmija dërgohet me urgjencë në sallë të operacionit, ku thirret ekipi kujdestar i mjekëve të ORL-së, ata thërresin me urgjencë mjekët e anestezionit, ku pas ndërhyrjes me bronkoskop, fëmijës i largohet pjesa e lodrës,



i lirohen rrugët e frymëmarrjes dhe i shpëtohet jeta. Mjekët apelojnë tek prindërit që të tregojnë kujdes të shtuar për fëmijët, duke mos u lënë gjëra të imëta që mund t'i gëlltisnin dhe ta rrezikojnë jetën dhe shëndetin e tyre.

Sekuestrohen rreth 250 pako "Argeta" në Kamenicë, një person i kishte kontrabanduar nga Serbia

PRISHTINË, 13 SHKURT - Policia e Kosovës ka njoftuar se më 12 shkurt në hyrje të fshatit Novosellë të Kamenicës është vërejtur një veturë me targa vendore, për të cilën kishte informatë se ishte duke

kontrabanduar mallra nga Serbia përmes fshatit Breznice. Gjatë kontrollit të automjetit i cili drejtohej nga H. Gj., (viti i lindjes 1972, mashkull kosovar), është vërejtur se i dyshuari kishte

pasur të ngarkuar rreth 250 pako me "Argeta" me nga 14 copë, gjithsej 3 500 copë, për të cilat nuk kishte asnjë dokument dhe dyshohet se kanë prejardhje nga Serbia. Lidhur me rastin të gjitha

veprimet janë ndërmarrë në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit, ku me urdhër të prokurorit kompetent malli i kontrabanduar sekuestrohet dhe dërgohet në terminalin doganor - Dheu i Bardhë.



Policia gjen fletushka në veri që bëjnë “thirrje për rezistencë”

PRISHTINË, 13 SHKURT - Policia e Kosovës ka nisur hetimet pasi në Mitrovicë të Veriut, persona ende të panjohur, kanë shpërndarë fletushka të ndryshme që bëjnë “thirrje për rezistencë” dhe “nxitje të urrejtjes”. Partia kryesore e serbëve në Kosovë ka thënë se me veprime të tilla po tentohet të fajësohen serbët “për incidente të reja të mundshme”.

Në raportin e rregullt 24-orësh, policia tha se fletushkat u shpërndanë në hyrje të ndërtesave dhe në rrugë të ndryshme.

Zëvendësudrejtori i policisë për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha se dyshohet se këto fletushka u shpërndanë “dje gjatë dhe pas protestës”. “Nuk ka të dyshimtë e as të arrestuar”, tha Elshani.

Fletushkat, që janë nënshkruar nga “Mbrotja Popullore”, të cilat janë shpërndarë në kanale të ndryshme në “Telegram”, përmbajnë udhëzime të supozuara për rezistencë ndaj Policisë së Kosovës. Ndër të tjera, në këto fletushka thuhet se Policia

e Kosovës duhet të qëllohet me ndonjë mjet, të pështyhen pjesëtarët policorë e të ofendohen. Pastaj, të thyhen makinat policore me ndonjë mjet si dhe jepen instruksione si të bëhen koktej molotovi dhe të ngjashme.

Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar, u bëri thirrje qytetarëve në veri që “të mos bien pre e provokimeve të tilla”.

Sipas kësaj partie, kushdo që i ka bërë këto veprime ka pasur për synim ta minojë paqen dhe ta thellojë paqëndrueshmërinë “në mënyrë që serbët të fajësohen për incidente të reja të mundshme”.

Në Mitrovicë të Veriut më 12 shkurt serbët protestuan kundër vendimit të autoriteteve të Kosovës për ndalimin e përdorimit të dinarit serb për pagesa.

Protestuesit kërkuan që të anulohet një rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës, që hyri në fuqi më 1 shkurt, e cila parasheh që vetëm euroja të jetë valuta për



kryerjen e pagesave.

Disa orë pas protestës, BQK-ja njoftoi për zgjatjen e fazës së tranzicionit për zbatimin e kësaj rregulloreje, e cila nuk mund të jetë

më e gjatë se tre muaj. Paraprakisht, kjo fazë tranzicioni ishte thënë se do të zgjaste gjatë shkurtit.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti,

ka thënë se vendimi i BQK-së nuk nënkupton ndalimin e dinarit, as ndalimin e mbështetjes që Serbia jep për serbët e Kosovës përmes dinarit.

BE-ja: Projektligji për KPM-në të mos ndikojë negativisht në lirinë e medieve

PRISHTINË, 13 SHKURT - Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë tha se ndryshimet në Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve (KMP) duhet të bëhen në atë mënyrë që nuk do të kenë “ndikim negativ” në lirinë e medieve.

Në një përgjigje dërguar “Radios Evropa e Lirë”, zëdhënësja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Ioanna Lachana, tha se blloku evropian ka avokuar vazhdimisht që Kosova ta rishikojë Ligjin për KPM-në në mënyrë që ai të jetë në përputhje me Direktivën e BE-së për mediet audovizuale. “Është thelbësore që Kosova të miratojë ligjin me shpejtësi përmes një procesi të hapur dhe transparent, me konsultimet e duhura, ku do të përfshihet shoqëria civile dhe organizatat mediale”, tha zëdhënësja e Zyrës së BE-së.

Lachana tha se BE-ja aktualisht është duke analizuar ndryshimet në Projektligjin për KPM-në dhe më pas do të japë komente për të “tek autoritetet kompetente”. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, Këshilli i Medieve të



Shkruara të Kosovës, por edhe një grup i organizatave ndërkombëtare i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë nga ndryshimet në projektligjin i cili synon rregullimin e medieve online. Ata e kanë parë këtë legjislacion si “sulm” ndaj medieve, duke

shprehur drojën se ekzekutivi mund ta përdorë këtë ligj për t'i censuruar mediet.

I ashtuquajtur i Projektligji për Komisionin e Pavarur të Medieve është miratuar nga qeveria më 27 dhjetor të vitit të kaluar dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës.

Legjislacioni parasheh që mediet online, që prodhojnë video, duhet të regjistrohen si biznes. Me ndryshimet, KPM-ja do të ketë mandat ta monitorojë edhe punën e medieve online që prodhojnë përmbajtje audio-vizuale. Ndryshimet në legjislacion

parashohin gjoba deri në 40 000.00 euro për mediet që bëjnë shkelje të ndryshme ligjore.

Aktualisht tekstet e publikuara në mediet online monitorohen nga Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovës. Ai nuk gjobit mediet për gabimet e tyre, por merr vendime për ankesat e bëra ndaj medieve dhe më pas vendimet e Këshillit mund të përdoren për të ngritur padi civile ndaj medieve nëpër gjykatat e Kosovës.

Ndërkohë, përmbajtja audio-vizuale e publikuar në mediet online nuk monitorohet nga askush. Këshilli i Medieve të Shkruara ka thënë se në shumicën e rasteve videot e publikuara shoqërohen me një tekst për të njëjtën temë dhe kështu bëhet monitorimi edhe i tyre.

Në Raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian është thënë se “amendamenti, që është aktualisht në proces, do të duhej ta harmonizonte më tej Ligjin me Direktivën e Shërbimeve të Medieve Audio-Vizuale për t'i shtirë kompetencat e tij edhe në mediet audio-vizuale online”.

Fillojnë aktivitetet e para të projektit “Open Source Technologies for Geospatial Research and Development”

PRISHTINË, 13 SHKURT - Në Departamentin e Gjeografisë filluan aktivitetet e para të projektit “Open Source Technologies for Geospatial Research and Development”, në kuadër të “Programi të granteve të mbështetjes së universitetit


2023/24” nga Kosovo United States Alumni (KUSA).

Projekti synon t'u ofrojë studentëve dhe mësuesve mjete dhe metodologji gjeohapësinore moderne për studime gjeografike ose të ngjashme.

Projekti po implementohet nën udhëheqjen e fituesit të grantit, Ferat Krasniqi, asistent në Departamentin e Gjeografisë dhe në bashkëpunim me organizatën Free Libre Open Source Software Kosova (FLOSSK).



Ndalesa e importeve nga Serbia rrit çmimet në Kosovë



PRISHTINË, 13 SHKURT - Ndalimi i importit të mallrave nga Serbia në Kosovë është reflektuar me shtrenjtimin e disa produkteve në treg, thotë Kreshnik Bublaku, menaxher i një qendre tregtare në Kosovë. Ai tregon se si pasojë e ndalesës, furnizime të caktuara duhet të bëhen nga destinacione më të largëta - çfarë ndikon drejtpërdrejt në rritjen e çmimeve. Përfaqësues të odave ekonomike në vend thonë se qeveria duhet ta heqë këtë masë pasi, sipas tyre, përveçse prek çmimet, ndikon edhe tek investitorët e mundshëm. Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj pyetjes së "Radios Evropa e Lirë" nëse po e shqyrton heqjen e ndalesës.

Bublaku, i cili menaxhon qendrën tregtare "Jora Center", thotë se kjo kompani, pos prodhimeve vendore, siguron tashmë prodhime direkte nga vendet e originës në Bashkimin Evropian, të cilat më herët siguroheshin nga Serbia ose përfaqësitë e kompanive të huaja në Serbi. Meqë transporti është më i gjatë dhe kushton më shumë, disa çmime është dashur të rriten, thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Bublaku merr si shembull lëngjet "Bravo" të kompanisë austriake "Rauch". "Lëngjet e prodhuara nga kjo kompani janë shtrenjtuar deri në 20 për qind, pasi furnizohemi nga Austria - vend i originës", thotë Bublaku.

Një shishe prej 0.5 litrash me këtë lëng ka kushtuar 55 centë në shtator të vitit 2023, kurse aktualisht është 79 centë.

"Radio Evropa e Lirë" iu drejtua degës së kompanisë "Rauch" në Serbi rreth humbjeve që mund t'i ketë pësuar nga ndalesa e Kosovës, por nuk mori përgjigje. Në shtatë-tetë muajt e fundit çmime më të shtrenjta kanë edhe disa produkte të tjera, thonë qytetarë të anketuar nga "Radio Evropa e Lirë" në Prishtinë. "Qumështi, jogurti, sheqeri dhe

çaji, muajt e fundit, janë shtrenjtuar shumë. Mezi po ia dalim", thotë Lumnije Berisha, e cila punon në një kompani të mirëmbajtjes dhe paguhet 320 euro në muaj.

Në qershor të vitit të kaluar, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, një kilogram sheqer është shitur për 1.10 euro, ndërsa aktualisht shkon deri në 1.40. Një litër qumësht - varësisht nga prodhuesi - ka kushtuar deri në 1.20, ndërsa kushton deri në 1.35. Albana thotë se edhe çmimet e disa artikujve higjienikë janë rritur tashmë. "Deterxhenti, shamponi, artikujt e tjerë për pastrim...", numëron ajo.

Këtyre pohimeve u bën jehonë edhe Afrim Hyseni, pronar i kompanisë "Sharri Center", e cila merret me shitjen e produkteve ushqimore, higjienike dhe të tekstilit.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai tregon se shumicën e produkteve të importuara nga Serbia i ka zëvendësuar me produkte nga vendi, rajoni dhe BE-ja.

Sa më larg që është destinacioni i furnizimeve, aq më i shtrenjtë edhe transporti dhe pastaj çmimi i produktit në treg, thotë ai.

Përveç në Kosovë, "ne furnizohemi më shumë në Gjermani, Kroaci dhe Shqipëri", thotë Hyseni.

Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se gjatë vitit të kaluar vlera e importeve nga shtete si Turqia, Gjermania etj. është rritur në krahasim me vitin 2022.

Kosova prej vitesh përballet me deficit të lartë tregtar, që do të thotë se importon shumë më shumë sesa që eksporton. Mesatarisht në vit ajo importon mallra në vlerë prej 5 miliardë eurosh, ndërsa eksporton nën 1 miliard.

Për kohë të gjatë Serbia ishte ndër shtetet me praninë më të madhe të produkteve të saj në Kosovë, të cilat tani janë të pavërejtshme. Brenda një dite ky vend eksportonte mbi një milion euro mallra në Kosovë.

Nga qershori deri në dhjetor të vitit të kaluar - kur ishte në fuqi ndalesa e vënë nga Qeveria e Kosovës - Serbia eksportoi në tregun e Kosovës mallra në vlerë prej 75 milionë eurosh krahasuar me rreth 240 milionë euro sa ishte vlera në periudhën e njëjtë të vitit 2022.

Produktet nga Serbia me vite ishin ndër dominueset në tregun e Kosovës. Në vitin 2022 ky shtet eksportonte brenda një dite në Kosovë produkte në vlerë prej më shumë se një milion eurosh.

"Të hiqet ndalesa"

Odat ekonomike në Kosovë i bëjnë thirrje qeverisë ta heqë ndalesën mbi produktet finale nga Serbia.

Përfaqësuesit e tyre thonë se kostoja e transportit ka ndikuar që disa çmime të jenë më të larta, por nuk specifikojnë më shumë.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se ndalesa, përveçse ndikon në çmime, "cenon edhe interesat e

kompanive ndërkombëtare, të cilat impiantet prodhuese i kanë në shtetin e Serbisë". "E, rrjedhimisht, cenohen edhe interesat e shteteve partnere të Republikës së Kosovës, përfshirë këtu Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe shtetet e Bashkimit Evropian", thotë ai.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se ndalesa duhet të kishte një periudhë të caktuar kohore. "Nuk mund të ekzistojë ndalesa një vit për arsye të sigurisë", sipas tij. Rafuna, i cili është edhe udhëheqës i Odave të Ballkanit Perëndimor, tërheq vërejtjen se situata e krijuar me shkëmbimet tregtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, ndikon edhe në tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë.

Investitorët potencialë, sipas tij, e shohin tregun e Ballkanit Perëndimor si një treg të vetëm dhe pengesat që paraqet Kosova, mund të bëjnë që investitorët të hezitojnë ta shtrijnë kapitalin e tyre në Kosovë. "Një investitor kualitativ, serioz, një brend i njohur botëror - i cili është marketingu më i mirë për të dëshmuar se një shtet është stabil për investime - e sheh komplet tregun e Ballkanit si një treg të vetëm. Kosova nuk është dashur që të vendosë pengesa në qarkullimin e mallit", thotë Rafuna për "Radion Evropa e Lirë".

Në një deklaratë dhënë "REL"-it vitin e kaluar, ministri për Komunitete dhe Kthim i Kosovës, Nenad Rashiq, tha se qeveria në periudhën e ardhshme do të duhej

ta anulonte vendimin për ndalimin e importit të mallrave serbe, por se pret që edhe Bashkimi Evropian t'i anulojë masat e tij ndëshkuese ndaj Kosovës.

BE-ja ndërmori masa ndëshkuese kundër Kosovës, përfshirë anulimin e disa fondeve dhe takimeve të nivelit të lartë për shkak se Kosova nuk iu bind disa kërkesave të saj për ta shtensionuar situatën në veriun e vendit, të banuar me shumicë serbe. Ato masa mbeten ende në fuqi.

Aleancat e bizneseve, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi, tërheqën vazhdimisht vërejtjen se situata e paqëndrueshme politike ndikon negativisht në ekonominë e të dyja vendeve. Për këtë çështje, "REL"-i raportoi edhe në tetor të vitit të kaluar.

Për arsye të ndryshme, Kosova edhe në të kaluarën ndërmori masa kufizuese kundër prodhimeve nga Serbia, gjë që rezultoi pastaj me rritje çmimesh. Për shembull, në fund të vitit 2018 Qeveria e Kosovës vendosi taksë, fillimisht 10% e më pas 100%, mbi produktet e Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, e cila mbeti në fuqi deri në shkurt të vitit 2020.

Katër muaj pas vendosjes së taksës, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës treguan se shkalla e inflacionit ishte rritur - në mars të vitit 2019 ishte 3.3 për qind, në krahasim me muajin mars të vitit 2018.

Të dhënat e tanishme të Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë se çmimet e konsumit në tregun e Kosovës në vitin 2023 ishin për 4.9 për qind më të larta, krahasuar me vitin 2022. Sipas tyre, prodhimet ushqimore u shtrenjtuan për 11.3 për qind, vitin e kaluar.

Në rritjen e çmimeve, megjithatë, ndikoi edhe inflacioni që filloi të rritej nga pandemia e koronavirusit dhe mori hov pasi Rusia nisi luftën në Ukrainë në vitin 2022.

Pse i ndaloi Kosova importet nga Serbia?

Qeveria e Kosovës mori vendimin për t'i ndaluar importet nga Serbia më 15 qershor të vitit 2023. Vendimi pasoi arrestimin e tre policëve të Kosovës nga forcat serbe.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e cilësoi atëkohë ndalesën si masë të sigurisë, dhe jo ekonomike apo tregtare. Ndërkohë që policët dolën nga paraburgimi për t'u mbrojtur në liri, masa e ndalesës së

prodhimeve nga Serbia vazhdoi. Që nga ajo kohë nga Serbia në Kosovë hyjnë vetëm lëndë e parë dhe gjysmë-produkte të nevojshme për prodhimin final, konfirmon Dogana e Kosovës.

DeepFakes po përdoren gjithnjë e më shumë. Dhe janë pasqyrë e botës sonë seksiste

Deputetja viktoriane Georgie Purcell kohët e fundit foli kundër një imazhi të redaktuar në mënyrë dixhitale në mediat e lajmeve, që kishte ndryshuar trupin dhe kishte hequr pjesërisht disa nga veshjet e saj.

“Durova jo pak dje.

Por bërja e trupit dhe veshjes sime me fotoshop nga një media nuk ishte ndër letrat e bingos për mua. Vini re gjinjtë e zmadhuar dhe veshjen, për t’u bërë më zbuluese. Nuk mund ta imagjinoj që kjo të ndodhë me një deputet mashkull.” Pavarësisht nëse redaktimi u ndihmua apo jo nga intelijenca artificiale (AI), përvoja e saj tregon dëmet e mundshme seksiste, diskriminuese dhe me bazë gjinore që mund të ndodhin kur këto teknologji përdoren të pakontrolluara.

Përvoja e Purcell pasqyron gjithashtu një prirje shqetësuese në të cilën imazhet, veçanërisht të grave dhe vajzave, seksualizohen, “fajësohen” dhe “nudifikohen” pa dijeninë ose pëlqimin e vetë personit.

Çfarë lidhje ka AI?

Termi AI mund të përfshijë një gamë të gjerë softuerësh kompjuterikë dhe aplikacionesh për smartphone që përdorin një nivel të caktuar të përpunimit të automatizuar.

Edhe pse historitë fantastiko shkencore mund të na bëjnë të mendojmë ndryshe, pjesa më e madhe e përdorimit të përditshëm të mjeteve të asistuar nga AI është relativisht e thjeshtë. Ne i mësojmë një programi kompjuterik ose një aplikacioni smartphone se çfarë duam të bëjmë, ai mëson nga të dhënat që ne i ushqejmë dhe e zbaton këtë mësim, për të kryer detyrën në mënyra të ndryshme.

Një problem me redaktimin e imazhit nga AI është se këto mjete mbështeten në informacionin që shoqëria jonë njerëzore ka



gjeneruar. Nuk është rastësi që udhëzimi i një mjeti për të redaktuar një fotografi të një graje mund të rezultojë në atë që ajo të duket më e ri, më e hollë dhe/ose më me forma dhe akoma më pak e veshur. Një kërkim i thjeshtë në internet për “gratë” do të zbulojë shpejt se këto janë cilësitë që shoqëria jonë mbështet.

Probleme të ngjashme janë shfaqur në mjetet e njohjes së fytyrës të inteligjencës artificiale, që kanë keqidentifikuar të dyshuarit në hetimet penale për shkak të paragjykimëve racore dhe gjinore që kanë softuerët. Fantazmat e seksizmit dhe racizmit, me sa duket, janë të pranishme në makina.

Teknologjia reflekton tek ne mungesën e respektit, pabarazinë, diskriminimin dhe – në trajtimin e Purcell – seksizmit të hapur që vetë kemi krijuar dhe qarkulluar tashmë.

“Deepfake” të seksualizuara

Edhe pse çdokush mund të jetë

viktimitë e abuzimit të bazuar në imazhe të krijuara nga AI, ose falsifikimeve të seksualizuara, nuk është sekret se ka pabarazi gjinore në imazhet pornografike që gjenden në internet.

Sensity AI (dikur Deeptrace Labs) ka raportuar për video të rrejshme në internet që nga dhjetori 2018 dhe ka gjetur vazhdimisht se 90–95% e tyre janë pornografi jo konsensuale. Rreth 90% e tyre janë femra.

Gratë e reja, fëmijët dhe adoleshentët në të gjithë globin po i nënshtrohen krijimit dhe ndarjes jo konsensuale të imazheve të gjenjeshërta, të seksualizuara dhe nudifikuara. Raportet e fundit të imazheve seksuale të falsifikuara të vajzave adoleshente kanë dalë nga një shkollë e mesme e Nju Xhersit në Shtetet e Bashkuara dhe një shkollë tjetër e mesme në Almdralejo, Spanjë. Një rast i tretë u raportua në një shkollë të mesme në Londër, e cila kontribuoi në vetëvrasjen e një vajze 14-vjeçare.

Gratë e famshme janë gjithashtu



një objekt i imazheve të gjenjeshërta seksuale. Vetëm muajin e kaluar, falsifikimet e seksualizuara të Taylor Swift u shpërndanë hapur në një sërë platformash dhe uebsajtesh dixhitale.

Ndërsa të dhënat kërkimore mbi normat më të gjera të viktimizimit dhe kryerjes së këtij lloji redaktimi dhe shpërndarjes së imazheve janë të pakta, sondazhi i vitit 2019 në Mbretërinë e Bashkuar, Australi dhe Zelandën e Re zbuloi se 14.1% e të anketuarve të moshës 16 deri në 84 vjeç kishin përjetuar situatën ku dikush krijonte, shpërndante ose kërcënonte se do të shpërndante një imazh të ndryshuar në mënyrë dixhitale, që i përfaqëson ato në një mënyrë të seksualizuar.

Studimi i Conversation hodhi dritë edhe mbi dëmet e kësaj forme abuzimi. Viktimat raportuan se kishin përjetuar trauma psikologjike, sociale, fizike, ekonomike dhe ekzistenciale, të ngjashme me dëmtimet e identifikuara nga viktimat e formave të tjera të dhunës seksuale dhe abuzimit të bazuar në imazhe.

Si mund t’i japim fund abuzimit të lehtësuar nga AI?

Abuzimi i Swift-it në një forum të tillë publik ka rindezur një thirrje për ligje federale dhe rregullore të platformave, moderim dhe standarde të komunitetit për të parandaluar dhe bllokuar shpërndarjen e falsifikimeve seksuale.

Fokusimi në shtete individuale nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar këtë problem global. Deepfakes seksuale dhe përmbajtjet e krijuara nga AI kryhen ndërkombëtarisht, duke theksuar nevojën për veprim kolektiv global.

Ka disa shpresa se ne mund të

mësojmë të zbulojmë më mirë përmbajtjen e krijuar nga AI përmes udhëzimeve për zbulimin e falsifikimeve. Por realiteti është se teknologjitë po përmirësohen vazhdimisht, kështu që aftësitë tona për të dalluar “të vërtetën” nga “e falsifikuara” dixhitale janë gjithnjë e më të kufizuara.

Përparimet në teknologji janë të shoqëruara nga disponueshmëria në rritje e aplikacioneve “nudify” ose “hiq veshjet”, në platforma të ndryshme dhe dyqane virtuale aplikacionesh, të cilat zakonisht reklamohen në internet. Aplikacione të tilla normalizojnë më tej trajtimin dhe objektvizimin seksist të grave, pa marrë parasysh se si mund të ndihen vetë viktimat për këtë.



Por do të ishte gabim të fajësohej vetëm teknologjia për dëmet, ose seksizmin, mosrespektimin dhe abuzimin që rrjedh prej saj. Teknologjia është moralisht neutrale. Nuk mund të marrë as merito, as fajet.

Në vend të kësaj, ka një përgjegjësi të qartë për zhvilluesit e teknologjisë, platformat dixhitale dhe faqet e internetit për të qenë më proaktivë duke ndërtuar sigurinë sipas projektimit. Me fjalë të tjera, vendosja e sigurisë dhe e të drejtave të përdoruesve përpara dhe në qendër në hartimin dhe zhvillimin të produkteve dhe shërbimeve online. Platformat, aplikacionet dhe faqet e internetit gjithashtu duhet të bëhen përgjegjëse për parandalimin, ndërprerjen dhe heqjen në mënyrë proaktive të përmbajtjeve dhe teknologjive jo konsensuale që mund të krijojnë një përmbajtje të tillë.

Nevojitet veprim dhe bashkëpunim i mëtejshëm global nëse me të vërtetë duam të trajtojmë dhe parandalojmë dëmet e falsifikimeve të seksualizuara jo-konsensuale. / TruthHub – Bota.al

Burimi: The Conversation





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Muja pas debutimit me gol te Samsunspor: Jam i lumtur, ndihem si në shtëpi

SAMSUN, 13 SHKURT - Sulmuesi shqiptar Arbnor Muja ka shënuar në debutim te skuadra turke Samsunspor. Djaloshi mitrovicas la Anwterpin për t'u transferuar te klubi turk dhe vetëm pas tri ditësh debutoi me fanellën e Samsunsporit në fitoren 2-0 ndaj Antalyasporit. 25-vjeçari u inkuadrua në

minutën e 69 dhe shënoi nga brenda zonës në minutat shtesë për rezultatin përfundimtar. Pas debutimit dhe golit, Muja u intervistua nga mediet turke, ku nuk hezitoi të tregojë se ndihet i lumtur me golin, fitoren dhe te klubi i ri ndihet si në shtëpi. "Mendoj se ishte ndeshje e

vështirë dhe jam i lumtur që fituam. E kam ditur që një atmosferë e tillë na pret në stadium, pasi kemi tifozë të jashtëzakonshëm. Jam, po ashtu, shumë i lumtur që jam lojtar i Samsunsporit. Kam shënuar golin e parë në ndeshjen e parë dhe kjo më bëri shumë të lumtur", ka

thënë Muja. "Jam për kohë të shkurtër këtu, për vetëm tri ditë. Por, ndihem mirë, si në shtëpi. Bashkëlojtarët, stafi i klubit dhe trajnerët janë faktor i madh që më bëjnë të ndihem kështu. Jam i lumtur për këtë. Nuk është e lehtë të adaptohesh kaq shpejt për vetëm një apo dy ditë. Do të



punojmë shumë që të vazhdojmë me rezultate pozitive", ka shtuar Muja.

Mbahet tryeza e pestë për sportin

"Epoka e re"

Prishtinë, 13 shkurt - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, së bashku me Komitetin Olimpik të Kosovës, kanë mbajtur tryezën e pestë për sportin, derisa në këtë tryezë është diskutuar për ligjin e ri të sportit i cili do të sjellë ndryshime dhe reforma të shumta për mënyrën e funksionimit të federatave sportive dhe sportit në përgjithësi. Pjesë e kësaj tryeze ku u diskutua për Ligjin e ri të Sportit, Ligjin Antidoping si dhe ndikimin e reformës sportive në komunitetin sportiv ishin zëvendësministria për Kulturë, Rini dhe Sport, Daulina Osmani, presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi,

presidenti i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Fidel Ylli, sekretari i përgjithshëm i Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, Gerti Shima dhe shumë sportistë dhe gazetarë sportivë. Zëvendësministria e Sportit, Daulina Osmani, ka thënë se gjatë vitit 2023 sporti ka marrë mbështetjen më të madhe sportive ndër vite, duke u mbështetur me mbi 25 milionë euro, 10 milionë prej të cilave ishin si mbështetja direkte nga ana e MKRS-së dhe 15 të tjera nga Ligji i Sponsorizimit. "Viti 2023 e përmblylëm me mbi 25 milionë euro mbështetje direkte për aktivitetet sportive në vend, 10 milionë mbështetje direkte nga Ministria e Sporti dhe 15 milionë të tjera nga Ligji i Sponsorizimit. Kjo është mbështetja më e



madhe të cilën e ka marrë sporti vendor ndër vite e të cilën këtë vit po synojmë ta rrisim edhe më shumë", ka thënë Osmani. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka thënë se ligji i sportit

të Kosovës ka nevojë që të kalojë nëpër një reformë të re e cila hap rrugë edhe për përfitime shumë më të mëdha për sportin e së ardhmes. Ligji i ri për sport parasheh edhe kompensimin e

ish-sportistëve të cilët kanë kontribuar në kohën e okupimit, kurse do të shkojë për ta marrë miratimin dhe votimin në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Presidenti i FFK-së priti në takim lamtumirës ambasadorin Abbott



PRISHTINË, 13 SHKURT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, priti të martën në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Nicholas Abbott. Me këtë rast, kreu i FFK-së shprehu mirënjohjen e tij të thellë për mbështetjen e vazhdueshme që ambasadori ka ofruar për federatën dhe futbollin e Kosovës. Ai ka thënë se ambasadori Abbott ka qenë një partner i vërtetë për

promovimin e vlerave pozitive që futbollit i përfaqëson, derisa mbështetja e tij ka qenë frymëzim për federatën në misionin e saj për gjithëpërfshirje. Në anën tjetër, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar lavdëroi punën e FFK-së dhe përkushtimin e saj që t'u jepen mundësi të barabarta për lojën e futbollit të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë. Ai ka thënë se në mesin e kujtimeve më të mira nga misioni i tij

diplomatik në Kosovë pashmangshëm do të mbetet mikpritja e jashtëzakonshme që iu bë Kombëtares së Anglisë, për çka falënderoi edhe një herë FFK-në, tifozët "Dardanët" dhe të gjithë qytetarët e Kosovës. Në shenjë respekti dhe mirënjohje për kontributin e tij, presidenti Ademi i dhuroi ambasadorit Abbott fanellën e Kombëtares së Kosovës dhe një mirënjohje për bashkëpunimin korrekt.

Luigj Quni vazhdon me Amicitia Zuerich, Arlinda Hajdari me Bjerringbro

PRISHTINË, 13 SHKURT - Lojtari i Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Luigj Quni, ka vazhduar edhe për tri vjet kontratën me skuadrën e suksesshme zvicerane Amicitia Zuerich. Pivoti Quni është kapiten i skuadrës, me të cilën ka fituar Kupën e Zvicrës në vitin 2022. Me kontratën e re, Quni do të jetë te skuadra nga

Zuerichu deri në vitin 2027. Tek Amicitia Zuerich janë shprehur shumë të lumtur që do ta kenë kosovarin në radhët e tyre edhe për tri vjet të tjera. Me shumë sukses këtë kampionat po paraqitet edhe hendbollistja e Kosovës, Arlinda Hajdari. Ajo po shfaq vlerat në kampionatin e Danimarkës, që është prej më cilësorëve në botë. Së fundi

Arlinda e ka vazhduar edhe për një vit kontratën me skuadrën Bjerringbro, për të cilën do të paraqitet edhe në edicionin garues 2024/2025. Te Bjerringbro e kanë vlerësuar shumë lart kontributin e Arlindës në mbrojtje dhe në sulm, ndërsa kanë shprehur gëzimin që do ta kenë edhe më tutje në skuadër.



Ferrari paraqet bolidin e ri para nisjes së sezonit në Formula 1

Maranello, 13 shkurt - Ferrari është skuadra e shtatë në Formula 1 që paraqiti pamjen e veturës për sezonin e ri dhe tifozët e skuadrës italiane janë të kënaqur me të. Tifozët janë të kënaqur me dizajnin e makinës

së re të Ferrarit të quajtur SF24 dhe shpresojnë që jo vetëm të jetë "i këndshëm për syrin" në pistë, por edhe konkurrues. "Shpresojmë të jetë sa i shpejtë aq dhe i bukur", komentoj një fans i Ferrarit pas prezantimit të

bolidit të ri. Drejtuesit dhe fansat shpresojnë që këtë vit ta përmirësojnë performancën dhe ta zgjidhin problemin e madh që kishin me degradimin e gomave. Charles Leclerc, i cili nënshkroi

një zgjatje shumëvjeçare dhe Carlos Sainz, i cili do të largohet nga skuadra pas sezonit, do të jenë në timon këtë sezon, si dhe vitin e ardhshëm do të zëvendësohet nga Lewis Hamilton.



Rapid Bukureshti krenohet me treshen 'dardane'

BUKURESHT, 13 SHKURT - Klubi rumun Rapid Bukuresht është krenar dhe mburret me lojtarët nga Kosova të cilat janë yjet më të mëdhenj të skuadrës. Rapid Bukureshti po përjeton një formë të lartë me katër fitore radhazi në Superligën e Rumanisë. Klubi nga kryeqyteti është në vendin e dytë me 45 pikë dhe po rivalizon në luftën për titull me liderët e FCSSB me 54 pikë. Kjo formë e mirë dhe renditja në vendin e dytë është edhe falë yjeve nga Kosova, të cilët po kalojnë në formë të lartë.

Albion Rrahmani e nisi në mënyrë të përkryer sezonin me 6 gola nga 7 ndeshjet e para, por u ndal nga një lëndim që e mbajti jashtë fushave për disa muaj. Megjithatë, pas rikthimit, sulmuesi llapjan ka shënuar edhe dy gola të tjerë nga katër ndeshje, duke qenë lojtari kryesor i Rapidit. Në afatin kalimtar të janarit, klubi



rumun transferoi edhe dy yje të tjerë nga Kosova, Ermal Krasniqin nga CFR Cluj dhe Florent Hasanin nga Tirana. Ermali shpejt u bë pjesë e formacionit titullar duke luajtur tri ndeshje dhe shënuar një gol. Edhe Hasani ka filluar menjëherë t'i marrë minutat e vet duke luajtur në dy ndeshje titullar

dhe duke dhuruar një asistim. Forma e mirë dhe prejardhja nga vendi i njëjtë ka bërë që Rapid Bukureshti t'u kushtojë një postim të treve së bashku. "The Kosovar Gang" apo në shqip "Banda kosovare", ka shkruar klubi rumun në rrjetin social "Facebook".

Golden State në një moment magjik, Milwaukee 'leksion' kampionëve të Denverit



MILWAUKEE, 13 SHKURT - Milwaukee nuk zhgënjën para tifozëve të vet, pasi e ka mposhtur me rezultat 112-95 Denverin. Antetokounmpo ishte protagonist për Bucksin, duke realizuar 36 pikë e 18 rebounde, ndërsa 29 pikët e 12 reboundet e Jokiqit për mysafirët mbetën për statistikë. Minnesota qëndron ende në krye të renditjes

në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 121-100 në fushën e Clippersave. Ndeshje e komanduar nga miqtë, ku u dalluan Townsi me 24 pikë e Edwardsi me 23. Irvingu dhe Doniqi, me nga 26 pikë secili, i dhanë fitoren Dallasit, që e mundi me shifrat 112-104 Washingtonin. Fitoi edhe Houstoni, që mundi

me rezultat 105-103 New Yorkun, sfidë ku u dallua Brooksi me 23 pikë. Fitorja e pestë radhazi për Golden Staten, që po kalon një moment të mirë. Ekipi i Warriorsit e mposhti me rezultat 129-107 Utah Jazzin, ku dyshja Curry-Thompson realizoi 51 pikë. Philadelphia, falë 24 pikëve të Hieldit, mundi me rezultat 123-121 Clevelandin.

REZULTATET

Charlotte - Indiana	111-102
Cleveland - Philadelphia	121-123
Atlanta - Chicago	126-136
Toronto - San Antonio	99-122
Houston - New York	105-103
Memphis - New Orleans	87-96
Milwaukee - Denver	112-95
Dallas - Washington	112-104
Utah Jazz - Golden State	107-129
Clippers - Minnesota	100-121

Sarri: Bayerni në letër favorit, por le ta shohim fushën

Te Lazio gjithçka është gati për ndeshjen e parë të 1/16-tës në Ligën e Kampionëve. Beteja ndaj Bayern Munchenit mbërrin në Olimpico

dhe për djemtë e Maurizio Sarri do të jetë një sfidë shumë e ndërlikuar për t'u përballur. "Duhet të mendojmë se nuk është e

pamundur, përndryshe në kokën tonë tashmë jemi të mundur. Ata vijnë si favoritë, ne duhet të shkojmë në fushë me entuziazëm sepse

është një ndeshje e bukur për t'u përjetuar. Besim, sepse ndoshta janë më të fortë, por duhet të kesh besim për të provuar gjithçka.

Duhet shumë nerva, pa mendime të dyta. Në letër ata janë favoritë, por le ta shohim fushën", është shprehur Sarri, trajneri i Lazios.

SHKURT

Drejtori i Leverkusenit: Alonso nuk do të largohet

Drejtori i Përgjithshëm i Bayer Leverkusenit, Simon Rolfes, u ka dhënë fund lajmeve për të ardhmen e trajnerit Xabi Alonso, të cilin mediet e lidhnin me kalimin te Liverpooli apo edhe te Real Madridi. Në një prononcim zyrtar, Rolfes ka deklaruar se Alonso do të vazhdojë të jetë trajner i Leverkusenit. "Nëse Xabi Alonso qëndron? Po, jam i sigurt për këtë. Kontrata e tij është një gjë, fakti që ai ndihet rehat, me familjen, me veten dhe që e di se çfarë ka në këtë klub është një tjetër gjë. Domethënë këtu ka një ekip të shkëlqyer që do të ketë perspektiva të shkëlqyera edhe për vitin e ardhshëm", ka deklaruar Rolfes.

Dy klube shfaqin interesim për Gulerin

Futbollisti Arda Guler ka luajtur shumë pak në këtë edicion për shkak të një lëndimi të rëndë. Talenti turk mund të largohet nga Real Madridi në verë. Sipas raportimeve të medieve spanjolle, janë dy klubet që kanë shfaqur interesim të lartë për Gulerin. Bëhet fjalë për skuadrën e Premierë Ligës, Tottenham Hotspur dhe atë të Bundesligës, Bayer Leverkusen.

Mainzi shkarkon trajnerin e dytë brenda këtij sezoni

Skuadra e Mainzit e ka shkarkuar trajnerin Jan Siewert. Klubi gjerman bën me dije se 41-vjeçari nuk do të jetë më në krye të ekipit dhe shkak për këtë janë bërë rezultatet e dobëta. Siewert mori drejtimin e Mainzit pas shkarkimit të Bo Svenssonit dhe në 12 ndeshje ai mori vetëm një fitore. Sot pritet që klubi i Mainzit ta paraqesë trajnerin e ri i cili ka 13 ndeshje në dispozicion për të tentuar ta ngrehë skuadrën në renditjen tabelore. Mainzit renditet në vend të 17 me 12 pikë, ndërsa Siewert bëhet trajneri i dytë që shkarkohet nga ky klub gjatë sezonit 2023-2024.

Ter Stegen: Nuk dorëzohemi në garë për titull

Marc-Andre ter Stegen u kthye për të luajtur për Barçën pas operacionit të tij në shpinë. Portieri gjerman kundër Granadës ka pësuar tre gola, por e ka shpëtuar disa herë të tjera Barcelonën për të mos pësuar më shumë gola. Kapiteni ka thënë se Barcelona nuk dorëzohet në garën për titull në La Liga. "Sezoni është i gjatë. Është diçka që varet nga ne nëse mund të fitojmë të gjitha ndeshjet që na kanë mbetur deri në fund. Do të luajmë kundër Realit, kundër Gironës dhe kemi mundësi të rikuperojmë pikë. Por duhet të përmirësohemi ndjeshëm, duhet të fokusohemi te vetja. Titulli në La Liga është i vështirë, ka ekipe me shumë personalitet dhe asnjë ndeshje nuk është e lehtë për t'u fituar. Klasifikimi na dënon të jemi aty ku jemi, por nuk tregon plotësisht realitetin", ka thënë Ter Stegen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Frappe Nshesh” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810108193 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Frappe Nshesh” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810108193 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Frappe Nshesh” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810108193 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Hana Group” SH.P.K. me seli në Vushtri, me pronar Enis Pantina, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811550898 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Hana Group” D.O.O. Vushtrri, sa vllasnikom Enis Pantina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811550898 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Hana Group” L.L.C. with headquarters Vushtrri, with owner Enis Pantina, has come to the decision to quit its business: 811550898 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ordinanca “ECHO-SOPI” shpall të pavlefshme certifikatën biznesit me nr. Unik Identifikues: 70391963.

- Nurije Fazliu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Xheladin Deda” Mitrovicë.

- Art Muhaxhiri nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të shkollës “Hajdar Dushi”.

- Muhamer Bujari shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Xhynaze Cena shpall te pavlefshme dëftesat e kl BI - IX shfmu “ Lidhja e Prizrenit “ Prizren.

- Halid Asllani shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu “28 Nentori “ Brodosan Dragash.

- Halid Asllani shpall te pavlefshme dëftesën e vitit I Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Blerina Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e vitit të parë dhe të dytë të shkollës “Nexhmedin Nixha”.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

